

VENDIM
Nr. 32, datë 28.1.2000

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË SESIONIT TË PARË TË KOMISIONIT TË
PËRBASHKËT NDËRQEVERITAR, SHQIPTARO-KROAT, PËR BASHKËPUNIMIN
EKONOMIK DHE TREGTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr.8371, datë 9. 7. 1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të sesionit të parë të komisionit të përbashkët ndërqeveritar, shqiptaro-kroat, për bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta